

Te nderuar kliente,

Shoqeria INSIG JETË sh.a., si nje nder kompanite me te medha ne tregun shqiptar te sigurimeve, ka monitoruar dhe vijon te monitoroje ne kohe reale situaten e krijuar.

Pervec burimeve zyrtare mbi te dhenat per situaten te publikuara ne faqen zyrtare te Ministrise se Shendetesise se Republikes se Shqiperise, <https://shendetesia.gov.al/koronavirusi-i-ri-dhe-masat-ndaj-tij/>, shoqeria monitoron tregun edhe ne nivel nderkombetar, permes shkembimit te informacionit me partneret e saj ne Evrope e me gjere.

Informacione te rendesishme zyrtare mbi virusin Covid-19 mund t'i gjeni:

- Rregullat per t'u mbrojtur nga Covid-19, klikoni ju lutem ne link <https://shendetesia.gov.al/perdorimi-i-sakte-i-maskave-kundra-koronavirusit/>
- Vaksina ndaj Covid-19, klikoni ju lutem ne link <https://shendetesia.gov.al/vaksina-anticovid-pyetje-pergjigje/>

Per cdo informacion shtese, qe Ju nuk arrini ta gjeni ne faqe zyrtare, ju lutem na shkruani ne info@insig-jete.al dhe do t'Ju kthejme pergjigje ne adresen Tuaj te e-mailit.

Nese jeni i pasigurt per proceduren, ne do t'ju ndihmojme duke ju referuar disa hapa, sa me poshte:

Si te kryeni nje tampon ne rast se keni simptoma te Covid-19?

- Sipas udhezimeve te Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, nr.30 date 16.03.2020 "Per Triazhimin e Pacienteve nga mjeku i familjes", nr. 30 date 16.03.2020 parashikohet se eshte mjeku I familjes ai qe referon kryerjen e testit te tamponit.

Sipas ketij dokumenti kryerja e tamponit referohet nese pacienti ka shenja klinike, mbi te cilat mjeku i familjes gjykon se ai/ajo mund te jete i infektuar me Covid-19 dhe vendos ne rekomandim

1. Simptomat e shfaqura prej pacientit
2. Diagnoza (suspect Covid-19)

Mjeku i familjes Ju asiston dhe referon rastin Tuaj te organet kompetente.

- Permes platformes e-albania, duke u kycur si perdorues, Ju ofrohet mundesia e gjetjes se numrit te mjekut tuaj te familjes, me te cilin mund te kontaktoni ne rruge telefonike.

Ne faqen kryesore te e-albania, per te marre informacion per mjekun e familjes, shkoni tek :

Hapi 1 : Shendetesia dhe mbrojtja sociale

Hapi 2: Karta e shendetit

Hapi 3: Perdor

dhe menjehere del emri i mjekut dhe nr. i kontaktit te tij.



Per Ju te nderuar kliente te sigurimit te shendetit vullnetar

- Insig Jetë ka vendosur ne dispozicion te klienteve te saj numrat e kontaktit ne kartat e klienteve per konsulta rreth COVID-19 me mjeket e kompanise, 24/7.
- Sipas termave te ripara te kontratave te sigurimit, me qellimin e mire te lehtesimit te kesaj situate te veshtire, shoqeria e sigurimit mund te mbuloje edhe shpenzimet per diagnostifikimin e Covid-19.
Duke ofruar mbulim per kryerjen e Tamponit, testit serologjik ne kontribuojme ne rritjen e sigurise ne pune dhe parandalimin e perhapjes se pandemise.
- Trajtimi Post-Covid eshte parashikuar ne kontratat tona te sigurimit pas perhapjes se pandemise dhe perfshijne diagnostifikimin dhe trajtimin mjekesor perkates.

Per Ju udhetare, edhe ne kohe pandemie!

Ju urojme udhetim te sigurte dhe mberritje sa me te shpejte ne destinacion!

Mbani ju lutem parasysh sa me poshte disa detaje:



Policat standard te sigurimit te shendetit ne udhetim, perfshire edhe ato te Sigurimit te Studentit, nuk ofrojne mbulimin per mbulim te shpenzimeve mjekesore per raste pandemie.

- Tregoni kujdes te shtuar gjate udhetimit Tuaj, respektoni maksimalisht masat e sigurise ne vendin e nisjes dhe te destinacionit.
- Nese nuk eshte urgjente, shmangni udhetime per moshen e trete, ne kete menyre nuk i ekspozojme ata ndaj riskut.
- Merrni informacion ne internet mbi situaten e krijuar nga Covid-19 ne vendin e destinacionit, ju ndihmon te pergatiteni.

- Insig Jetë mund t'Ju asistojë me informacion orientues nëse na shkruani në adresën zyrtare info@insig-jete.al